Në Japoni ndodhi njëri nga aksidentet, me siguri, më të shtrenjta në histori, në të cilën për fat asnjë nuk është i lënduar. Në një rrugë të territorit në prefekturën Jamaguçi, siç transmeton televizioni HTV, dje janë përplasur tetë automobila sportiv nga marka luksoze "ferari" dhe tre "mercedesë". Arsyeja për ndeshjen masive është tentimi i pasuksesshëm i ndryshimit të shoferit të njërit prej automobilave të ferarit, kumtoi policia.

Në incizimin e HTV-së mund të shihet një numër më i madh i ferarëve të kuq, të ngjitur njëri pas tjetrit. Në aksident, siç është kumtuar, nuk ka të lënduar.

-qgprm9LXqA

Phoca PDF